

URDHËR
Nr. 193, datë 13.5.2015

PËR LICENCIMIN E AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TE PRODUCENTËVE “AMP”

Duke marrë parasysh propozimin nr. 445 prot., datë 4.5.2015, të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit, për licencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv të të Drejtave te Producentëve “AMP”,

KONSTATOVA:

Se, në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 9380, datë 28.4.2005, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, i ndryshuar, është kompetencë e ministrit të Kulturës, miratimi i dhënies së licencës, kësaj Agjencie, në fushën e menaxhimit kolektiv të të drejtave të producentëve “AMP”.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 1, të nenit 108 dhe pikave 1 dhe 3, të nenit 109, të ligjit nr. 9380, datë 28.4.2005, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Licencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Producentëve “AMP”.
 2. Afati i licencës është 3 (tre) vjet nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I KULTURËS
Mirela Kumbaro Furxhi